



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2022:243758

Datë: 15.12.2022

Numri i dokumentit: 03758979

**C.nr. 1016/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- DEGA NË VITI**, gjyqtari Arben Xheladini, në çështjen kontestimore të paditëses, E.S., nga fshati, Komuna e Vitisë, me datë 15.12.2022, jashtë seance, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

Konsiderohet e tërhequr padia e paditëses E.S..

**A r s y e t i m**

Me datë 25.10.2019, E.S. e ka dorëzuar një padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e cila me aktvendimin e datës 04.05.2020 është shpallur jo kompetete në pikëpamje territoriale, dhe ka vendosur që pasi aktvendimi të bëhet i formës së prerë, shkresat e lëndës t'i dërgojë në Gjykatën Themelore në Gjilan-Dega në Viti<sup>1</sup>.

Me aktvendimin e datës 22.11.2022, paditëses i është kthyer në plotësim parashtrësia, të cilën, sipas fletkthesës, e ka pranuar personalisht me datë 30.11.2022. Në këtë aktvendim, paditësja i ka pasur të përcaktuara qartë se cilat veprime duhej ndërmarrë, e po ashtu është paralajmëruar për pasojat ligjore në rast të dështimit për të vepruar brenda afatit ligjor.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjykata ka konstatuar se paditësja nuk i ka ndërmarrë veprimet e kërkuara dhe afati i caktuar tashmë ka kaluar.

Nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 102.3 të LPK-së sipas të cilit "Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësia po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësia do të hidhet poshtë", lidhur me nenin 142 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**G j y q t a r i,**

**Arben Xheladini**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, pas ditës së pranimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa, në kopje të mjaftueshme, dorëzohet në këtë Gjykatë.

<sup>1</sup> Me datë 18.11.2022, Gjykata i ka pranuar shkresat e lëndës nga Gjykata Themelore në Prishtinë.